

AKT THEMELIMI

I SHOQËRISË " 3C Technology " SH.P.K.

Sot, me datë 29/09/2022,

Z.Daniel Vathkruja, shtetas Shqiptar , i biri i Markut, lindur më 16/12/1994, në Shkoder/Shqiperi, banues në Tirane/Shqiperi e mbajtës i ID me nr . J41216077W , madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kam vendosur të themeloj një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "**3C Technology**" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

NENI 1

EMËRTIMI

Emri i Shoqërisë është "**3C Technology**" Sh.p.k.

NENI 2

SELIA

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: *Rruga Prokop Mima, Qendra Kristal Zona kadastrale 3292 Njesia bashkiake nr 5, Tirane.*

Asambleja e ortakëve mund të themelojë filiale, seli dytësore ose njësi të tjera operative si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

NENI 3

KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asmablesë së Ortakëve.

NENI 4

OBJEKTI

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:

- Aktivitet ne fushen e sherbimeve te konsulences se marketingut dhe shitjeve online.*
- Sherbim inbound dhe outbound, brenda vendit dhe ne tregun nderkombetar.*
- Sherbime te formimit profesional dhe trajtimeve te personelit.*
- Aktivitet ne fushen e Real Estate dhe te cdo aktiviteti te lejuar nga legjislacioni shqiptar per shoqerite tregtare qe mund te vleresohet rentabel nga asambleja e shoqerise.*

Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

NENI 5

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributet në të holla të ortakëve themelues në vlerën 100.000 (Njeqind mije) Leke dhe është i ndarë në 1 kuota.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **Z.Daniel Vathkruja, lindur me 16/12/1994**, zoteron 1 kuotë, me 100 % të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 100.000 (Njeqind mije) Leke të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

NENI 6

ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori i vetëm, **Z.Daniel Vathkruja**, i cili zgjidhet për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, nga 27.09.2022 – 27.09.2027, me të drejtë rizgjedhjeje.

NENI 7

LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 8

DISPOZITA FINALE

Ky Akt Themelimi hartohet në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Permbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortakët themelues të shoqërisë.

ORTAKËT THEMELUES

Z. Daniel Vathkruja